

VENDIM

Nr.10, datë 4.1.2008

PËR MBËSHTETJEN E PRODHIMIT BUJQËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2008, zëri “Transferte në buxhetet familjare” për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, si më poshtë vijon, për:

- prodhimin e vajit të ullirit extra-vergine;
- mbrojtjen e ullishteve nga miza e ullirit;
- certifikimin e produkteve bio;
- futjen e teknologjive të reja në ujitjen e pemëtoreve intensive;
- ruajtjen e produkteve bujqësore;
- prodhimin e fidanëve për llojet autoktone të rrushit;
- fermerët individualë, që ngrenë vreshta, pemëtore dhe ullishte të reja;
- serrat me ngrohje teknike, për ndryshimin e sistemit të përdorimit të lëndës djegëse nga naftë në solar;
- fermat blegtorale, që mbarështojnë lopë për qumësht, të matrikulluara dhe që e dorëzojnë prodhimin në qendrat e përpunimit, të regjistruara në organet tatimore;
- mbarështimin në kullota të blegtorisë së imët, të matrikulluar;
- shoqëritë e prodhimit dhe të tregtimit në bujqësi, të regjistruara në mbështetje të ligjit nr.8088, datë 21.3.1996 “Për shoqëritë e bashkëpunimit reciprok”, të ndryshuar;
- subvencionimin e normës së interesit për kreditë, që përdoren për veprimtaritë bujqësore.

2. Kriteret bazë për mbështetjen e prodhimit bujqësor dhe masa e përfitimit të jenë, si më poshtë vijon:

- për prodhimin e vajit të ullirit extra-vergine 100 lekë/litri;
- për mbrojtjen e ullishteve nga miza e ullirit 17 000 lekë/ha;
- për certifikimin e produkteve bujqësore bio nga bimët e kultivuara deri në 70 000 lekë/fermë;
- për ujitjen me pika në pemëtoret intensive, me sipërfaqe mbi 4 dy 300 000 lekë/ha;
- për blerjen e dhomave frigoriferike, për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, me kapacitete të vogla deri në të mesme 600 000 lekë/fermë;
- për prodhimin e fidanëve për llojet autoktone të rrushit “Kallmet”, “Debine” dhe “Vlosh” për fidanishte mbi 3 dy 1 200 000 lekë/ha;
- për ngritjen e vreshtit të ri, me sipërfaqe mbi 5 dy 500 000 lekë/ha;
- për ngritjen e pemëtoreve të reja, me sipërfaqe mbi 3 dy 300 000 lekë/ha;
- për ngritjen e ullishteve të reja, me sipërfaqe mbi 3 dy 300 000 lekë/ha;
- për serrat me ngrohje teknike, për ndryshimin e sistemit të përdorimit të lëndës djegëse nga naftë në solar 1 500 000 lekë/ha;
- për fermat blegtorale, që mbarështojnë jo më pak se 5 krerë lopë qumështi, të matrikulluara, dhe që e dorëzojnë prodhimin në qendrat e përpunimit, të regjistruara në organet tatimore 10 000 lekë/krerë në vit, për racat e pastra, dhe 5 000 lekë/krerë në vit për kryqëzimet dhe racat e vendit;
- për mbarështimin e dhenve në kullota, për vendqëndrime dhe lëvizje nga kullotat verore në ato dimërore dhe anasjellas, për tufat me mbi 50-150 krerë, të matrikulluara, 50 000 lekë/vit për fermë, dhe për tufat me 150 krerë 100 000 lekë/vit, për fermë;

- për shoqëritë e prodhimit dhe të tregtimit për ndërtesa, makineri bujqësore, pajisje për ruajtje dhe përpunim të prodhimit, deri 50 % të vlerës së investimit, por jo më shumë se 2 000 000 lekë në vit. Kjo mbështetje nuk jepet më shumë se 3 (tri) vite radhazi.

3. Kriteret më të hollësishme dhe procedurat për dhënien e mbështetjes përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Financave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha